

Termt e referencës (TeR)

për konsulentët ndërkombëtarë dhe vendorë për të përgatitur Strategjinë e Shërbimit Këshilldhënës për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2023-2026 në kuadër të programit “Zhvillimi ekonomik rural i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës (SIRED)”, financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC).

1. Historiku

13 vite pas pavarësisë, Kosova ende përballlet me shumë sfida, midis tyre institucione të dobëta, papunësia e lartë dhe pasiviteti i tregut të punës (veçanërisht midis grave dhe vajzave), migracioni, pabarazia e vazhdueshme gjinore nëpër sektorë të ndryshëm, si dhe diskriminimi i grupeve minoritare. Sektori i bujqësisë karakterizohet nga kapacitete të kufizuara prodhuese dhe organizative, mungesa e aksesit në njohuri dhe aftësi si dhe rreziqet mjedisore. SIRED synon të lehtësojë sisteme të tregjeve më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe të kontribuojë në uljen e varfërisë për popullsinë rurale, veçanërisht për gratë dhe grupet e marginalizuara.

Që nga tetori 2003, në departamentin e zhvillimit rural të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është krijuar Sektori i Shërbimeve Këshilldhënëse duke synuar zgjerimin e rritjes dhe rritjen e kapaciteteve të Shërbimeve Këshilldhënëse në një formë institucionale dhe të përhershme. Me kalimin e kohës, shërbimi këshilldhënës u zhvillua dhe me rregulloret e vitit 2013 u ngrit në nivelin e Departamentit. Gjithashtu, me strategjinë 2012-16 dhe me ligjin për shërbimet këshilldhënës u organizua si shërbim pluralist publiko-privat.

Me mbështetjen e projektit të financuar nga Komisioni Evropian "Mbështetje në forcimin e shërbimeve këshillimore të MBPZHR dhe përmirësimin e shërbimeve teknike të ofruara nga laboratorët e MBPZHR" është përgatitur Strategjia 2014-20 dhe janë hartuar udhëzime administrative që rregullojnë këtë sektor. Ky sistem është i përqendruar në Departamentin e Shërbimeve Këshilldhënëse Teknike dhe shtrihet në gjithë territorin e Kosovës si sektor publik përmes qendrave informative këshilluese në secilën komunë dhe organizatave private, të cilat janë organizata të licencuara që merren me këshilla për bujqësi. Aktualisht, strategjia 2014-2020 ka skaduar dhe Departamenti për Shërbime Këshilldhënëse Teknike po bën përpjekje për përgatitjen e strategjisë së re 2022-2028.

Projekti SIRED, ndër të tjera, synon shërbimet këshillimore për bujqësi, kapacitetet dhe zhvillimin organizativ të institucioneve kombëtare dhe lokale. Një nga dokumentet kyçe të shërbimit këshilldhënës për Strategjinë Bujqësore për Shërbimin Këshilldhënës të MBPZHR-së ka skaduar në vitin 2021. Ky plan bashkon një raport për statusin e shërbimeve këshilldhënëse për bujqësinë në Kosovë, bën një analizë SWOT dhe identifikon objektivat dhe pikat specifike të veprimit. MBPZHR kërkon që tani të përgatitet Strategjia për Shërbimin Këshilldhënës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SASARD) 2023-2026, për hartimin e së cilës kërkon mbështetje nga SIRED dhe konsulentët.

Konsulentët që kryejnë këta Terma të Referencës do të lehtësojnë dhe kontribuojnë në mënyrë aktive përkitazi me procesin e hartimit të dokumenteve, përgatitjen e SASARD 2023-2026 gjatë periudhës korrik 2022 deri më 15 dhjetor 2022, nën drejtimin e CACH dhe MBPZHR - Departamenti për Politika dhe Tregje Bujqësore.

2. Qëllimi

Qëllimi i Shërbimit Këshilldhënës është përmirësimi i sektorit bujqësor të Kosovës, si dhe rritja e produktivitetit bujqësor, përpunimi dhe tregtimi në mënyrë të qëndrueshme. Shërbimet këshilldhënës janë të rëndësishme për të ndihmuar MBPZHR-në në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Objektivi Kryesor:

Të hartojë një strategji për shërbimet këshilldhënës në bujqësi dhe zhvillim rural, e cila do të përdoret si udhërrëfyes pune për sistemin këshilldhënës të Kosovës për bujqësi dhe zhvillim rural, për të rritur aftësitë e stafit vendor në hartimin e strategjive dhe shkëmbimin e praktikave më të mira me vendet e BE-së.

3. Detyrat kryesore:

Eksperti do të punojë në bashkëpunim me ekipin për hartimin e strategjisë së përcaktuar, i cili përzgjedhet nga Departamenti i Shërbimeve Këshilldhënës Teknike dhe i zyrtarizuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR-së. Puna e ekspertit do të mbikëqyret nga përfaqësuesit e Caritas-it të Zvicrës në bashkëpunim të ngushtë me Udhëheqësin e ekipit.

Partnerët kryesorë fillestarë për këtë kontribut janë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti për Shërbimin Këshilldhënës Teknik dhe Ekipi për Hartimin e Strategjisë.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për hartimin e Strategjisë së sistemit këshilldhënës të Kosovës për bujqësi dhe zhvillim rural, partnerë indirekt do të jenë përfaqësuesit e sektorit privat dhe komunat.

Caritas i Zvicrës (CACH) në bashkëpunim me MBPZHR dhe konsulentët planifikon punëtorin të mëtejshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të ardhshme nga aktorë të ndryshëm për zhvillimin e shërbimeve/zgjerimit të këshilldhënies. Për më tepër, mbështetja konsulente për përgatitjen e SASARD 2023-2026 do ta shëndrrojë më tej atë në veprim shërbimin këshillimor të MBPZHR dhe planin e zhvillimit rural.

Ekspertët do të:

- Shqyrtojnë strategjinë e mëparshme se deri në çfarë mase është zbatuar ajo dhe të analizojnë situatën aktuale të Departamentit për Shërbimet Këshilldhënës Teknike.
- Hartojnë një strategji për shërbimet këshilldhënës në bujqësi dhe zhvillim rural në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Këshilldhënës dhe Teknike.
- Hartojnë planin strategjik në përputhje me ligjin për shërbimet këshilldhënës dhe dokumentet e tjera përkatëse të sektorit dhe të kryejnë aktivitetet e planifikuara, në koordinim të ngushtë me stafin e MBPZHR-së.
- Të këshillojnë Departamentin për Shërbime Këshillimore Teknike për organizimin e punës së shërbimit këshillues bazuar në praktikatat më të mira të BE-së të përshtatura me rrethanat e Kosovës.
- Të shqyrtojnë dhe vlerësojnë sektorin e shërbimeve këshillimore teknike përmes analizës SWOT ose metodave tjera adekuate të analizës.
- Mbështesin grupin punues të MBPZHR për përpilimin e strategjisë dhe validimin e strategjisë.
- Të bashkëpunojnë ngushtë me stafin e projektit CACH dhe MBPZHR - Departamenti për Shërbime Këshilldhënës Teknike për të organizuar seminare dhe tryeza të rumbullakëta me fokus grupet dhe aktorët kryesorë të sektorit gjatë përpilimit të SASARD.

- Të identifikojnë çështjet kryesore që lidhen me zhvillimin e strategjisë koncize dhe të zbatueshme.
- Të integrojnë informatën kthyesë të MBPZHR-së dhe palëve të tjera kyçe organike të interesit në draftin e SASARD.
- Të përcaktojnë qasjen më të mirë për zbatimin e planit strategjik për Departamentin e Shërbimeve Këshilldhënëse Teknike.
- Të informojë në mënyrë të rregullt stafin e CACH, MBPZHR për kryerjen e aktiviteteve.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër shtesë të caktuar sipas fleksibilitetit të kërkuar nga projekti.
- Konsulentët do të përgatisin metodologjinë e punës, rezultatet e pritura dhe ofertën financiare.

Rezultatet dhe të dorëzuarat e pritura:

- Të paraqesë raportin fillestar paraprak/të fillimit.
- Organizimi i punëtorive/diskutimeve në fokus grupe për hartimin e planit strategjik për Departamentin e Shërbimeve Këshilldhënëse Teknike.
- Hartimi i strategjisë bazuar në informacionin dhe komentet e marra nga grupi i punës, palët e interesit dhe aktorët kryesorë.
- Hartimi i draft strategjisë bazuar në standardet e BE-së dhe dërgimi në shërbimin këshillues për validim.
- Të interpretojë rezultatet dhe të shtjellojë analizën.
- Respektimi i metodave të propozuara dhe orarit të punës ose informimi i menjëhershëm i personit kontaktues të specifikuar në kontratë, në rast të përshtatjeve të nevojshme.
- Dorëzimi me kohë i rezultateve të specifikuara më lartë.

4. Profili i ekspertizës dhe konsulencës

Ekspertët duhet të kenë profilin e mëposhtëm (vendor ose ndërkombëtar):

- Diplomë Master në Bujqësi, Agroekonomi, Administratë Publike ose fusha të tjera të rëndësishme për detyrën.
- Të paktën 5 vjet përvojë në shërbimin këshilldhënës/zgjerues në sektorin e bujqësisë.
- Të paktën 5 vjet përvojë dhe njohuri të mira në hartimin e planeve strategjike të veprimit për Shërbimet Këshilldhënës dhe Zhvillimin Rural dhe dokumente të tjera të zhvillimit strategjik.
- Eksperiencë në zbatimin e projekteve dhe programeve në fushën e zbatimit të standardeve dhe “acquis” të BE-së në bujqësi dhe zhvillim rural.
- Njohja e kornizës së sektorit të shërbimeve këshilldhënëse/zgjeruese të vendit dhe BE-së.
- Aftësi për prezantim me gojë dhe shkrim teknik.
- Aftësi për të zgjidhur problemet dhe për të orientuar zgjidhjet.
- Qëndrim ndaj punës në ekip.
- Njohja e sektorit të bujqësisë dhe/ose e palëve të interesit që përfaqësojnë sektorë të tjerë ekonomik është përparësi.
- Eksperiencë profesionale specifike lidhur me kërkesat e pozitës dhe përvojë pune në sektorin publik dhe privat.
- Njohja e teknikave të qasjes pjesëmarrëse, proceseve të konsultimit dhe palëve të interesit do të merret si përparësi.
- Fleksibil përkitazi me orarin dhe aktivitetet e nevojshme për të arritur qëllimet e pozicionit.

- Njohuri të mira të softuerit më të zakonshëm (Microsoft Office, etj.).
- Aftesi të mira ndërpersonale të komunikimit.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar
- Fleksibil për sa i përket orarit dhe aktiviteteve të nevojshme për të arritur qëllimet e pozitës

5. Menaxhimi dhe raportimi

- Konsulentët e jashtëm do të kryejnë analizën nën drejtimin e ekspertëve të brendshëm të CACH dhe MBPZHR-së. Konsulenti do të jetë në krye për zbatimin e procesit të zhvillimit të përmbajtjes SASARD 2023-2026 d.m.th. në kryerjen e hulumtimit, analizës dhe raportimit. Ekspertët e brendshëm të CaCH dhe MBPZHR do të mbikëqyrin kontrollin e cilësisë (përfshirë redaktimin/rihartimin e raporteve), udhëheqin kërkimin e analizës dhe lehtësojnë mbajtjen e punëtorive dhe zhvillimin e kapaciteteve.
- Përgjegjësia e përgjithshme është e Drejtorit në nivel vendi të CACH në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin e projektit SIREG, të cilit i raporton konsulenti.
- Puna e konsulentëve do të përfshijë punë në terren dhe takime/punëtori në komuna të ndryshme të Kosovës, takime virtuale si dhe punë në zyrë.

6. Periudha kohore dhe qëllimi i detyrës

- Detyra do të fillojë me takimin fillestar pas nënshkrimit të kontratës.
- Fushëveprimi i detyrës është përafërsisht 20 ditë për konsulentin ndërkombëtar dhe 30 ditë për konsulentin vendor.

Specifikimet për procesin e dorëzimit të ofertave/procesit të aplikimit

Kandidatët/kompanitë e interesuara janë të lutur të dorëzojnë një kopje elektronike të shprehjes së interesit/propozimit të tyre deri në datën 14 korrik 2022 me temën REF: "Strategjia për Shërbimin Këshilldhënës dhe Zhvillim Rural" në emailin kosovo@caritas.ch duke e vendosur në CC vrruka@caritas.ch

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

- Profilin profesional të ekipit/kompanisë (CV-të e të gjithë individëve të përfshirë në ekipin e konsulencës).
- Përshtatshmërinë e konsulentëve për detyrën dhe përputhja me përvojën e mëparshme të punës, kualifikimet etj.
- Përbërjen dhe ndarjen e punëve midis anëtarëve të ekipit.
- Metodologjinë që do të prezantohet.
- Draftin e planit të punës dhe orari i propozuar.
- Oferta financiare duke përfshirë buxhetin e zberthyer dhe tarifat ditore individuale.

Oferta do të vlerësohet duke përdorur metodën më të mirë të vlerës për para (metoda e kombinuar e pikëve). Propozimi teknik do të vlerësohet me peshë 80%, ndërsa ai financiar me 20%. Shpenzimet e akomodimit dhe transportit duhet të përfshihen në ofertë.